PHILIPS

Boksi

TAVS300



# Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni mbështetje teknike në

www.philips.com/welcome

# Përmbajtja

1 Të rëndësishme .............................................. 2
Udhëzime të rëndësishme sigurie ........................2
Masa paraprake për baterinë.................................2
Njoftim..........................................................................2

2 Boksi me Bluetooth...................................... 4
Hyrje ...............................................................................4
Çfarë ka në kuti ..........................................................4
Përmbledhje e njësisë kryesore ............................4

3 Fillimi.................................................................. 5
Bateritë e brendshme.................................................5
Ndezja/fikja .................................................................5

4 Luajtja ................................................................ 6
Luajtja nga një pajisje me Bluetooth...................6
Luajtja nga një pajisje e jashtme...........................6
Kontrolli i luajtjes .......................................................6

5 Informacione për produktin ........................7

6 Zgjidhja e problemeve ................................. 8

# 1 Të rëndësishme

## Udhëzime të rëndësishme sigurie

- Boksi nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vendosni asnjë burim rreziku mbi boks (p.sh. objekte të mbushura me lëngje, qirinj të ndezur).
- Sigurohuni që të ketë hapësirë të lirë të mjaftueshme anembanë boksit për ajrim.
- Ju lutemi përdoreni boksin në mënyrë të sigurt në një ambient me temperaturë ndërmjet 0° dhe 45°.
- Përdorni vetëm pjesë dhe aksesorë të specifikuar nga prodhuesi.

## Masa paraprake për baterinë

- Rrezik shpërthimi nëse bateria nuk vendoset si duhet. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.
- Bateria (paketa e baterisë ose bateria e instaluar) nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së larë, si për shembull drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Nëse bateria përdoret, ruhet ose transportohet në temperatura tepër të larta ose tepër të ulëta, dhe në presion atmosferik tepër të ulët në lartësi të mëdha mund të përbëjë rrezik.
- Mos e ndërroni baterinë me një tip të gabuar që mund të shkelë një masë sigurie (për shembull, disa lloje baterish litiumi).
- Hedhja e baterisë në zjarr ose në furrë, ose shtypja apo prerja mekanikisht e baterisë mund të shkaktojë shpërthim.
- Lënia e baterisë në një ambient me temperaturë tepër të lartë, ose në një ambient me presion atmosferik tepër të ulët mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngjeve ose gazrave të djegshëm.

**Paralajmërim**

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e këtij boksi.
- Asnjëherë mos lubrifikoni asnjë pjesë të këtij boksi.
- Vendoseni boksin mbi sipërfaqe të sheshtë, të fortë dhe të qëndrueshme.
- Asnjëherë mos e vendosni këtë boks mbi pajisje të tjera elektrike.
- Përdoreni boksin vetëm brenda. Mbajeni boksin larg nga uji, lagështia dhe objektet e mbushura me lëngje.
- Mbajeni këtë boks larg nga drita direkte e diellit, flakët e ndezura ose nxehtësia.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria ndërrohet me një model të gabuar

## Njoftim

Këtu, TP Vision Europe B.V. deklaron se ky boks është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.philips.com/support.

Ky boks është ndërtuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.

Kur bashkëngjitet në produkt ky simbol i koshit me rrota dhe me kryq në një produkt, kjo do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.
Ju lutemi të jeni të informuar lidhur me sistemin e grumbullimit të veçantë në zonën tuaj për produktet elektrike dhe elektronike. Ju lutem veproni në përputhje me rregullat lokale dhe mos i hidhni produktet e vjetra së bashku me mbetjet normale shtëpiake.

Hedhja e produktit të vjetër në mënyrën e duhur do të ndihmojë në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Boksi përmban bateri që mbulohen nga direktiva evropiane 2013/56/EU, të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Ju lutem të informoheni për rregullat vendëse lidhur me grumbullimin veçmas të baterive pasi hedhja në mënyrën e duhur do të ndihmojë në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

**Kujdes**

- Heqja e bokseve të brendshme do ta bëjë të pavlefshme garancinë dhe mund ta prishë boksin.

Çojeni gjithnjë boksin te një profesionist për të hequr bateritë e brendshme.



## Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), polistirol (amortizuesi) dhe polietilien (qeset dhe fletë mbrojtëse sfungjeri).
Boksi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohet nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

**Shënim**

- Etiketa e të dhënave ndodhet mbrapa boksit.

# 2 Boksi me Bluetooth

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni boksin tuaj në www.philips.com/welcome.

## Hyrje

Me këtë boks, mund të dëgjoni audio nga pajisjet e pajtueshme me Bluetooth ose nga pajisjet e tjera audio.

## Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:

- Njësia kryesore
- Kabllo USB
- Kabllo audio
- Manuali i përdorimit
- Garancia mbarëbotërore

## Përmbledhje e njësisë kryesore




1. ⏻
   - Ndezja/fikja e boksit
2. ✱
   - Zgjidhni një funksion
   - Lidhni/shkëputni çiftimin me Bluetooth
3. ►❚❚
   - Fillo, ndalo ose vazhdo luajtjen
   - Kalo te kënga tjetër
4. Rrit/ul volumin
5. **5 V ⎓ 2 A**
   - Lidhni një kabllo USB
6. AUX IN
   - Lidhni një pajisje audio të jashtme

# 3 Fillimi

**Kujdes**

- Përdorimi i kontrolleve ose rregullimeve, ose përdorimi i procedurave të performancës përveç atyre që janë specifikuar këtu mund të sjellë rrezatim të rrezikshëm.

Ndiqni gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.
Nëse kontaktoni Philips, do të pyeteni për numrin e modelit dhe të serisë së këtij boksi. Numri i modelit dhe i serisë ndodhen mbrapa boksit. Shkruani numrat këtu:
Nr. i modelit __________________________
Nr. i serisë __________________________

## Bateritë e brendshme

Boksi mund të punojë me bateri të brendshme të karikueshme.
- Kur boksi është i ndezur dhe bateritë janë të rëna, "⏻" pulson.

### Karikoni bateritë e brendshme:

1 Lidhni njërën anë të kabllos USB me prizën **5 V ⎓ 2 A** në boks.
2 Lidhni anën tjetër të kabllos USB me një prizë (**5 V ⎓ 2 A**).




- Kur boksi është duke u karikuar, drita "⏻" është e ndezur.
- Kur bateritë janë plot, drita "⏻" fiket.

**Kujdes**

- Rrezik i dëmtimit të boksit! Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që është printuar mbrapa ose poshtë boksit.
- Rrezik goditjeje elektrike! Kur hiqni kabllon USB, tërhiqni gjithnjë spinën nga priza. Asnjëherë mos tërhiqni kordonin.
- Përdorni vetëm kabllo USB të specifikuar nga prodhuesi ose që shitet bashkë me këtë boks.

## Ndezja/fikja

Shtypni butonin ⏻ në boks për ta ndezur ose fikur.
- Boksi nxjerr një tingull kur ndizet.
- Nëse nuk është lidhur asgjë me prizën AUX IN, "ᛒ" pulson.

### Fikja e boksit automatikisht:

Boksi fiket automatikisht në rastet e mëposhtme:
- Në modalitetin Bluetooth: nëse nuk ka asnjë sinjal nga një pajisje Bluetooth për më shumë se 15 minuta.
- Në modalitetin AUX: nëse nuk lidhet asnjë pajisje për më shumë se 15 minuta.

# 4 Luajtja

## Luajtja nga një pajisje me Bluetooth

Mund të përcillni audio nga një pajisje te ky boks duke përdorur lidhjen Bluetooth.

**Shënim**

- Sigurohuni që të aktivizoni Bluetooth për ta bërë pajisjen të zbulueshme para se të bëni çiftimin.
- Boksi dhe pajisja duhet të ndodhen në distancën e pranueshme nga Bluetooth prej jo më shumë se 10 metrash.

1 Shtypni butonin ✱ në boks.
   - "✱" pulson ngjyrë blu për të lejuar lidhjen me valë.
   - Bluetooth aktivizohet automatikisht në boks nëse nuk lidhet asgjë në prizën AUX IN.

2 Në pajisjen Bluetooth, aktivizoni Bluetooth për ta bërë të zbulueshme.

3 Zgjidhni "Philips VS300" në pajisje për çiftim.
   - Për një pajisje më të vjetër, vendosni fjalëkalimin e çiftimit 0000.
   - Drita "✱" qëndron ndezur në ngjyrë blu kur lidhja është e suksesshme.

4 Shtypni butonin ► në pajisjen Bluetooth për të filluar përcjelljen e muzikës.

### Ndarja e çiftimit me Bluetooth

- Mbani shtypur butonin ✱ për 2 sekonda ose më shumë derisa "✱" të pulsojë.

## Luajtja nga një pajisje e jashtme

Mund të dëgjoni muzikë në boks nga një pajisje e jashtme audio.

1 Lidhni një kabllo audio në prizën AUX IN në boks dhe në xhekun e kufjeve në pajisjen e jashtme.
   - Boksi më pas kalon në modalitetin AUX IN.
   - "✱" fiket.




2 Shtypni butonin ► në pajisjen e jashtme për të filluar përcjelljen e muzikës.

## Kontrolli i luajtjes

Gjatë luajtjes

- Rrotulloni çelësin e volumit për të rritur/ulur volumin.
- Shtypni butonin ►❚❚ për të luajtur/ndaluar. Shtypni shpejt butonin ►❚❚ dy herë për të kaluar te kënga tjetër.
   - Punon vetëm në modalitetin Bluetooth.

# 5 Informacione për produktin

**Shënim**

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

## Informacione të përgjithshme

| | |
|---|---|
| Kërkesat për energjinë | 5 V ⎓ 2 A |
| Bateri litiumi | 3,7 V ⎓ 2200 mAh |
| Përmasat (Gje x La x The) | 110,5 x 87,5 x 53 mm |
| Pesha (njësia kryesore) | 2,75 kg |

## Amplifikuesi

| | |
|---|---|
| Fuqia output | 4 W |
| Përgjigja e frekuencës | 100 - 20000 Hz |
| Raporti sinjal-zhurmë | > 70 dB |

## Bokset

| | |
|---|---|
| Impedanca e boksit | 4 Ω |
| Fuqia input maksimale e boksit | 4 W |
| Drajveri i boksit | 1.75" rreze e plotë |

## Bluetooth

| | |
|---|---|
| Versioni i Bluetooth | 5.0 |
| Rrezja e frekuencave | 2402 - 2480 MHz |
| Fuqia maksimale e transmetuar | 5 dBm |
| Rrezja maksimale e komunikimit | rreth 10 m |
| Profilet Bluetooth të pajtueshme | A2DP |

# 6 Zgjidhja e problemeve

**Paralajmërim**

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e këtij boksi.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni boksin vetë.
Nëse hasni probleme ndërsa përdorni boksin, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkoni shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips (www.philips.com/welcome). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që boksi është pranë dhe që numri i modelit dhe numri i serisë të jetë i disponueshëm.

### Nuk ndizet

- Sigurohuni që boksi është i karikuar plotësisht.
- Sigurohuni që priza USB e boksit është lidhur si duhet.
- Si veçori e kursimit të energjisë, boksi fiket vetë pas 15 minutash nëse nuk merret sinjal audio ose nuk lidhet asnjë pajisje audio.

### Nuk ka zë

- Rregulloni volumin.

### Nuk ka përgjigje nga boksi

- Ndizeni përsëri boksin.

### Nuk luhet muzikë në këtë boks edhe pasi lidhja me Bluetooth është bërë me sukses

- Pajisja nuk mund të përdoret për të luajtur muzikë nëpërmjet këtij boksi me anë të valëve.

### Cilësia e audios është e dobët pas lidhjes me një pajisje me Bluetooth

- Sinjali i Bluetooth është i dobët Afrojeni më shumë pajisjen me boksin ose hiqni çdo pengesë mes tyre.

### Nuk lidhem dot me këtë boks

- Pajisja nuk mbështet profilet e nevojshme për këtë boks.
- Funksioni Bluetooth i këtij boksi nuk është aktivizuar. Shikoni manualin e përdorimit të boksit për të mësuar se si ta aktivizoni funksionin.
- Ky boks nuk është në modalitetin e çiftimit.
- Ky boks është lidhur tashmë me një pajisje tjetër me Bluetooth. Shkëputeni atë pajisje dhe pastaj provoni përsëri.

Philips dhe logoja me mburojën Philips janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. Dhe përdoren me licencë.
Ky produkt është prodhuar dhe shitet nën përgjegjësinë e TP Vision Europe B.V. ose të një prej filialeve të tij, dhe TP Vision Europe B.V. është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

TAVS300_00_UM_V1.0